

VENDIM
Nr. 583, datë 28.8.2019

PËR MBULIMIN E PLOTË TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ.
MARVELA GLLAVINA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të vendimit nr. 46, datë 30.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2019”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Marvela Gllavina, në masën 679 850 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama